



Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Bart

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Leje për Apelim të F00328

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Methju Halling

Valeria Boliçi

Xhejms Paç

Mbrojtësve të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bouden

Mbrojtësve të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

TRUPI GJYKUES II (“Trupi Gjykues”), në pajtim me nenet 21, 40(6)(h) dhe 45 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 77, 79(2) dhe 138(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), merr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 17 dhe 18 shtator 2021, Mbrojtja e Hysni Gucatit (“Mbrojtja e Gucatit”) dhe Mbrojtja e Nasim Haradinajt (“Mbrojtja e Haradinajt”) dorëzuan mocione me të cilat kundërshtonin pranueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve W04841 dhe W04842 të Prokurorit të Specializuar (bashkërisht, “Mocionet”).¹
2. Më 24 shtator 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) iu përgjigj Mocioneve.²
3. Më 27 shtator 2021, Trupi Gjykues lëshoi një urdhër me të cilin i rrëzonte Mocionet (“Urdhri”).³
4. Më 29 shtator 2021, Mbrojtja e Gucatit dhe Mbrojtja e Haradinajt dorëzuan kërkesa për rishikim të Urdhrit (“Kërkesat”).⁴
5. Më 30 shtator 2021, Trupi Gjykues autorizoi Mbrojtjen e Gucatit dhe Mbrojtjen e Haradinajt të paraqisnin kundërpërgjigje “për marrjen e vendimit në lidhje me Kërkesat [për rishikim]”.⁵

¹ F00317, Mbrojtja e Gucatit, *Mocion për Kundërshtim të Pranueshmërisë së Provave sipas Rregullës 138(1)*, 17 shtator 2021, konfidencial. *Shih edhe* F00317/RED, publik. F00318, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë sipas Rregullës 117(2) për Shpallje si të Papranueshme të Dëshmitarëve të Dëshmitarëve të ZPS-së*, 18 shtator 2021, konfidenciale. *Shih edhe* F00318/RED, publike.

² F00322, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Kundërshtimeve të Mbrojtjes në lidhje me Pranueshmërinë*, 24 shtator 2021.

³ F00328, Trupi Gjykues, *Urdhër mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117*, 27 shtator 2021.

⁴ F00335, Mbrojtja e Gucatit, *Kërkesë për Rishikim të Vendimit F00328*, 29 shtator 2021; F00338, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë për Rishikim të Vendimit F00328 mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117*, 29 shtator 2021.

⁵ F00344, *Urdhër për Mbrojtjen për Dorëzimin e Kundërpërgjigjeve ndaj F00322*, 30 shtator 2021, në veçanti, para. 5, 11.

6. Më 4 tetor 2021, Mbrojtja e Gucatit dhe Mbrojtja e Haradinajt dorëzuan kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes ("Kundërpërgjigjet").⁶

7. Më 7 tetor 2021, Trupi Gjykses i rrëzoi Kërkesat ("Vendimi i Kundërshtuar").⁷

8. Më 12 tetor 2021, Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi një kërkesë me të cilën kërkonte leje për të apeluar Vendimin e Kontestuar ("Kërkesa").⁸

9. Më 13 tetor 2021, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër me të cilin ua shkurtonte afatin ZPS-së dhe Mbrojtjes së Gucatit brenda të cilit t'i përgjigjeshin Kërkesës dhe urdhëroi mosdorëzimin e asnjë kundërpërgjigjeje.⁹

10. Më 14 tetor 2021, Mbrojtja e Gucatit iu bashkua Kërkesës.¹⁰ Po atë ditë, ZPS-ja u përgjigj.¹¹

II. PARASHTRIMET

11. Mbrojtja e Haradinajt kërkon leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar në lidhje me katër pika të përshkruara në shkronjat (a)-(d) të paragrafit 1 të Kërkesa ("Pikat"):

- a. Nëse Trupi Gjykses ka gabuar që mori vendim në lidhje me parashtrimet materiale përpara se Mbrojtja të parashtronte kundërpërgjigjen përkatëse që i takonte si e drejtë në bazë të rregullës 76 të Rregullores ("Pika I");

⁶ F00349, Mbrojtja e Gucatit, *Kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Kundërshtimeve të Mbrojtjes në lidhje me Pranueshmërinë* ("Kundërpërgjigjja e Gucatit"), 4 tetor 2021; F00348, Mbrojtja e Haradinajt, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes ndaj KSC-BC-2020-007/F00322*, ("Kundërpërgjigjja e Haradinajt"), 4 tetor 2021.

⁷ F00353, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Rishikim të Vendimit F00328*, 7 tetor 2021.

⁸ F00358, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë për Leje për Apel kundër Vendimit F00328* ("Kërkesa"), 12 tetor 2021.

⁹ F00362, Trupi Gjykses, *Urdhër për Ndryshim Afati për Përgjigje ndaj F00358*, 13 tetor 2021.

¹⁰ F00365, Mbrojtja e Gucatit, *Përgjigje ndaj Kërkesës për Leje për Apel kundër Vendimit F00328*, 14 tetor 2021.

¹¹ F00366, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës për Leje për Apel*, 14 tetor 2021.

- b. Nëse Trupi Gjykses ka gabuar, me dhënien mundësi fillimisht Mbrojtjes për të parashtruar kundërpërgjigjen pastaj me marrjen e vendimit në këtë aspekt në formë rishikimi, në vend që të merrte në shqyrtim pikat materiale lidhur me zbatimin e rregullës 117(2), Përgjigjen e ZPS-së dhe Kundërpërgjigjen e Mbrojtjes (“Pika II”);
 - c. Nëse Trupi Gjykses veprimi saktë me ushtrimin e *“kompetencës për të vendosur për një çështje pa pritur kundërpërgjigje”* pa bërë asnjë njoftim paraprak për këtë (“Pika III”); dhe
 - d. Nëse qëndrimi i mbajtur nga Trupi Gjykses dhe mosrishikimi i vendimit përbën *“arsyetim qartësisht të gabuar ose padrejtësi”* në kuptim të rregullës 79(1) të Rregullores (“Pika IV”).
12. Në thelb, Mbrojtja e Haradinajt parashtron se të katër Pikat kanë të bëjnë me interpretimin e rregullës 76 të Rregullores dhe sugjeron se Trupi Gjykses e ka keqinterpretuar këtë rregull në dëm të Mbrojtjes, duke mos i dhënë mundësi Mbrojtjes të kundërpërgjigjet përpara lëshimit të Urdhrit.¹²
13. Paraprakisht, Mbrojtja e Haradinajt parashtron se afati shtatëditor i vendosur nga rregulla 77(1) për të kërkuar leje për apel ka filluar më 7 tetor 2021 duke qenë se vendimi i Trupit Gjykses në këtë aspekt nuk ishte i vlefshëm dhe i formës së prerë deri pasi të kishte marrë në shqyrtim Kundërpërgjigjet dhe të merrte një vendim në bazë të tyre.¹³
14. Në Përgjigjen e saj, ZPS-ja parashtron se Kërkesa nuk i përmbush kushtet e rregullës 77 të Rregullores në lidhje me të katër Pikat.

¹² *Shih*, në veçanti, Kërkesa, para. 29-30.

¹³ Kërkesa, para. 7, 38.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

15. Rregulla 77(1) e Rregullores parashikon që kur një palë kërkon të apelojë vendimin e një paneli që nuk është i apelueshëm sipas Ligjit dhe Rregullores, pala në fjalë i parashtron kërkesë për leje për apelim të ndërmjetëm panelit që ka nxjerrë vendimin e kontestuar, brenda shtatë (7) ditësh prej daljes së vendimit.

16. Rregulla 79(2) e Rregullores parashikon që kërkesa për rishikimin e një vendimi nuk e pezullon afatin e paraparë për një mjet juridik.

17. Kushtet për lejen për apel parashikohen në nenin 45 të Ligjit dhe në rregullën 77(2) të Rregullores: Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor. E drejta për apel lind vetëm nëse paneli është i mendimit se janë përmbushur këto kushte.¹⁴

IV. DISKUTIM

A. PIKA I DHE PIKA III

18. Në lidhje me Pikën I dhe Pikën III të ngritura nga Mbrojtja, Kërkesa rrëzohet për arsyet e mëposhtme.

19. Së pari, Kërkesa është jashtë afatit në lidhje me këto dy pika sepse këto kanë të bëjnë, në thelb, me pretendime gabimi nga ana e Trupit Gjyqësor në Urdhrin e lëshuar

¹⁴ *Shih edhe* KSC-BC-2020-06, F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel*, 11 janar 2021, publik, para. 9.

prej tij më 27 shtator 2021. Kërkesa për leje për apel do të duhej të ishte dorëzuar brenda shtatë ditësh pas kësaj date.

20. Trupi Gjykses nuk e pranon argumentin e Mbrojtjes së Haradinajt se afati për të kërkuar leje për apel ka filluar me Vendimin e Kundërshtuar të datës 7 tetor 2021. Sipas rregullës 79(2) të Rregullores, afati brenda të cilit Mbrojtja mund të kërkojë leje për të apeluar Urdhrin ka filluar më datën e lëshimit të Urdhrit dhe ka përfunduar më 4 tetor 2021. Kur Trupi Gjykses miratoi lejen për kundërpërgjigje më 30 shtator, as e pezulloi këtë afat, as e shpalli të pavlefshëm Urdhrin. Me moskërkimin e lejes për të apeluar Urdhrin brenda afatit të zbatueshëm, Mbrojtja hoqi dorë efektivisht nga e drejta për këtë.

21. Një palë nuk mund ta kundërshtojë një vendim jashtë afateve të vendosura në Rregullore përmes dorëzimit të një mocioni për rishikim vendimi dhe, pas rrëzimit të këtij mocioni, ta kundërshtojë vendimin fillestar me anë të një apeli kundër vendimit mbi rishikimin. Rregullorja nuk e ofron një mundësi të tillë, e cila do t'i mundësonte palës të kërkonte leje për apel kur të preferonte vetë dhe jo në afatin e përcaktuar në Rregullore.

22. Rrjedhimisht, Mbrojtja, në lidhje me Pikën I dhe Pikën III, nuk e ka respektuar afatin sipas rregullës 77(1) të Rregullores. Vetëm kjo arsye do të mjaftonte për refuzimin e lejes për apel.

23. Por edhe nëse Kërkesa do të ishte dorëzuar brenda afatit në lidhje me këto pika, Mbrojtja nuk ka treguar, në pajtim me nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 77(2) të Rregullores, se Pika I ose Pika III do të ndikonin ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo rezultatit e gjykimit dhe se një zgjidhje e menjëhershme nga paneli i Gjykatës së Apelit do të mund ta përparonte thelbësisht procesin.

24. Siç thuhet më lart, Trupi Gjykses nuk ka vendosur ende nëse do të pranojë ndonjë prej materialeve të përmendura në Mocione.¹⁵ Asnjëri prej tyre nuk është parashtruar ende për praninë dhe Trupi Gjykses do të vendosë për praninë e deklaratave të paraqitura nga ZPS-së në mbyllje të dëshmimeve të dëshmitarëve W04841 dhe W04842. Rregullorja nuk i lejon asnjë pale të kundërshtojë pranueshmërinë e provave për arsye besueshmërie kur këto prova ende nuk janë parashtruar nga pala kundërshtare për praninë.¹⁶ Rrjedhimisht, Mbrojtja kërkon nga Trupi Gjykses një masë e cila nuk i takon sipas Rregullores.¹⁷

25. Siç është shprehur në mënyrë të përsëritur Trupi Gjykses, pikat e ngritura nga Mbrojtja janë aspekte që mund të ngrihen plotësisht, drejtësisht dhe efektivisht nëse dhe pasi deklaratat e dëshmitarëve W04841 dhe W04842 të paraqiten si prova dhe Mbrojtja do të ketë mundësi të bollshme për t'i shtjelluar këto pika gjatë pyetjeve të saj. Mbrojtja nuk cenohet padrejtësisht.¹⁸

26. Gjithashtu, siç del qartë në paragrafin 19 të Vendimit të Kundërshtuar, Trupi Gjykses ka marrë plotësisht në konsideratë argumentet që jepen në Kundërpërgjigjet. Rrjedhimisht, pretendimi se Trupi Gjykses ka gabuar në arsyetim me lëshimin e Urdhrit pa pritur Kundërpërgjigjet është i tejkaluar për shqyrtim për shkak të urdhrit të datës 30 shtator lëshuar nga Trupi Gjykses me të cilin dha leje për kundërpërgjigje dhe për shkak të shqyrtimit nga Trupi Gjykses të parashtrimeve të bëra pas tij.

27. Rrjedhimisht, Mbrojtja e Haradinajt nuk ka vërtetuar se Pika I dhe Pika III do të ndikojnë ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo rezultatit të gjykimit.

¹⁵ Urdhri, para. 12; Vendimi i Kundërshtuar, para. 24.

¹⁶ Urdhri, para. 12; Vendimi i Kundërshtuar, para. 24. Shih edhe F00334, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Praninë e Materialeve jo përmes Dëshmitarëve*, 29 shtator 2021.

¹⁷ Urdhri, para. 12; Vendimi i Kundërshtuar, para. 23. Shih edhe neni 40(6)(h) i Ligjit dhe rregulla 138(1) e Rregullores.

¹⁸ Urdhri, para. 12; Vendimi i Kundërshtuar, para. 24.

28. Mbrojtja e Haradinajt nuk ka vërtetuar se një zgjidhje e menjëhershme nga paneli i Gjykatës së Apelit do të mund ta përparonte thelbësisht procesin. Trupi Gjykses edhe një herë përsërit konstatimet e veta se Mbrojtjes do t'i jepet mundësi e plotë dhe e drejtë: (i) për të paraqitur kundërshtimet e veta ndaj pranimin të materialeve përkatëse, nëse dhe pasi të paraqiten nga ZPS-ja për pranim; dhe (ii) për t'u bërë pyetje këtyre dëshmitarëve në lidhje me materialet gjatë pyetjeve të saj të cilat Mbrojtja i konsideron të rëndësishme në kuadër të pranueshmërisë.¹⁹

29. Për këto arsye, refuzohet leja për të apeluar Pikën I dhe Pikën III.

B. PIKA II DHE PIKA IV

30. Sa i takon Pikës II dhe Pikës IV për të cilat kërkohet leje për apel, Trupi Gjykses vendos si vijon.

31. Lidhur me Pikën II, Mbrojtja nuk shpreh se ku qëndron gabimi në procedurën e ndjekur nga Trupi Gjykses në këtë aspekt. Mbrojtja ankohet se i është mohuar mundësia për të dorëzuar kundërpërgjigje ndaj Përgjigjes së ZPS-së. Për ta ndrequr këtë, Trupi Gjykses i dha leje Mbrojtjes të kundërpërgjigjej pavarësisht se Trupi Gjykses mund të merrte një vendim gjithsesi të vlefshëm pa pritur kundërpërgjigjet. Më tej Trupi Gjykses shqyrtoi: (a) nëse Kundërpërgjigjet dëshmonin arsye për rishikim sipas rregullës 79 të Rregullores; dhe (b) pavarësisht se nuk e bënë këtë, mori në konsideratë argumentet e parashtruara në Kundërpërgjigjet për të parë nëse do të prodhonin pasoja për Urdhrin. Pra, nuk kishte asgjë në procedurën e ndjekur që të dëshmonte gabim, e jo më të kishte diçka që përmbush kushtet e rregullës 77 të Rregullores.

32. Trupi Gjykses vëren gjithashtu se urdhri që lëshoi më 30 shtator 2021 vetëm sa i jepte Mbrojtjes leje për të dorëzuar kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së ZPS-së të datës

¹⁹ Urdhri, para. 12; Vendimi i Kundërshtuar, para. 24.

24 shtator 2021.²⁰ Në atë urdhër, Trupi Gjykses nuk konstatonte se Mbrojtja i kishte vërtetuar kushtet për rishikim sipas rregullës 79 të Rregullores. Trupi Gjykses jepte leje për kundërpërgjigje “[m]e qëllim marrjen e një vendimi në lidhje me Kërkesat [për rishikim vendimi]”.²¹ Për rrjedhojë, leja për kundërpërgjigje nuk ia hiqte Mbrojtjes detyrimin për të vërtetuar se ishin përmbushur kushtet për rishikim të vendimit. Rregullorja nuk parashikon asnjë lloj tjetër mase që do t’i lejonte një pale t’i kërkonte një paneli të rishikonte ndonjë prej vendimeve të veta pa i vërtetuar këto kushte. Dhe, siç konstatohet në Vendimin e Kundërshtuar, Mbrojtja nuk ka dëshmuar se janë përmbushur kushtet për rishikim të vendimit në këtë rast.²²

33. Lidhur me Pikën IV, pavarësisht se Mbrojtja nuk i ka vërtetuar kushtet për rishikim të vendimit sipas rregullës 79 të Rregullores, Trupi Gjykses e rishikoi *gjithsesi* Urdhrin e vet në bazë të argumenteve që jepeshin në Kundërpërgjigjet.²³ Për këtë arsye, pretendimi se Trupi Gjykses nuk ka marrë në konsideratë Kundërpërgjigjet dhe se, rrjedhimisht, ka gabuar është i pabazë dhe bie ndesh me dokumentacionin.

34. Mbështetur në sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja nuk ka dëshmuar në pajtim me nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 77(2) të Rregullores se Pika II ose Pika IV do ta ndikonin ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo rezultatin e gjykimit dhe se një zgjidhje e menjëhershme nga paneli i Gjykatës së Apelit do ta përparonte thelbësisht procesin.

35. Rrjedhimisht, leja për apel refuzohet edhe në lidhje me këto Pika.

V. VENDIMI

36. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

²⁰ F00344, Trupi Gjykses, *Urdhër për Mbrojtjen për Dorëzimin e Kundërpërgjigjeve ndaj F00322*, 30 shtator 2021, para. 11-12.

²¹ *Shih më lart* para. 5.

²² Vendimi i Kundërshtuar, para. 26.

²³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 22.

- a. **RRËZON** Kërkesën në tërësi; dhe
- b. **SHPALL** kërkesën e Mbrojtjes për efekt pezullues si të tejkaluar.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E premte, 15 tetor 2021

Hagë, Holandë